clastertech

Clastertech Kosove
Ukshin Hoti C4/2,Lok Nr: 8
10000 Prishtinë - Kosovë

Clastertech Albania
Emin Duraku, Njësia Nr: 5
1001, Tiranë - Albania

Republika e Kosovës

Organ Shqyrtues i Prokurimit
Adresa: Rr. "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës, Kati V-të), Prishtinë, Kosovë
Tel: + 383 38 212 309

Lënda: "Furnizim me Licenca per Microsoft Office 365 dhe Antivirus per nevojat e N.H. Iber Lepenc"
Numri i prokurimit: IL-24-4372-1-2-1
Numri i brendshëm: IL-24-021-121

Lënda: KËRKESË PËR RISHQYRTIM *08.07.2024, Prishtinë*

I nderuar Organ Shqyrtues i Prokurimit ,

Si institucioni më i lartë i fushës së prokurimit, po ju drejtohemi lidhur me procedurën "Furnizim me Licenca per Microsoft Office 365 dhe Antivirus per nevojat e N.H. Iber Lepenc".

Bazuar në Ligjin për Prokurimin Publik të Kosovës 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, Udhëzuesin Nr.001/2023 Për Prokurim Publik si dhe Rregulloren Nr.001/2022 për Prokurimin Publik, ne, operatori ekonomik Clastertech Sh.P.K, fillimisht i shpallur operator fitues, e pastaj i shpallur si operator I pasuksesshëm, parashtrojmë ankesë kundër vendimit mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të paraqitur nga OE Clastertech Sh.P.K lidhur me procedurën "Furnizim me Licenca per Microsoft Office 365 dhe Antivirus per nevojat e N.H. Iber Lepenc" me numër prokurimi: IL-24-4372-1-2-1 / IL-24-021-121.

Më datë 04.07.2024 përmes emailit të sistemit e-prokurim, kemi pranuar disa dokumente nga AK Nderrmarrja Iber Lepenc Sh.A.

04.07.2024 08:39	*Vendim per pezullim te aktivitetit te prokurimit 2 _ 021.pdf*
04.07.2024 09:35	*Vendim per refuzimin te kerkeses per rishqyrtim 02 021.pdf*
04.07.2024 10:01	*B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK 021RIVLERESIM.pdf*

SH. P. K. Clastertech PRISHTINË

Dosja e Tenderit

Dosja e Tenderit Shqip 021.Doc

Hape: Shkarko të gjithë dokumentacionin | Word dokumenti

Dokumenti shtojca
20.05.2024 10:25 Sqarimi ishtesë _IL-24-4372-1-2-1.pdf
Hape: Shqip

Dokumenti shtojca
12.06.2024 16:39 Vendim për pezullimin e aktivitetit të prokurimit 021.pdf
Hape: Shqip

Dokumenti shtojca
14.06.2024 10:40 Vendim per aprovim te kerkeses per rishqyrtim infosoft.pdf
Hape: Shqip

Dokumenti shtojca
04.07.2024 08:39 Vendim per pezullim te aktivitetit te prokurimit 2 _ 021.pdf
Hape: Shqip

Dokumenti shtojca
04.07.2024 10:01 B58 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK 021 RIVLERESIM.pdf
Hape: Shqip

Dokumenti shtojca
04.07.2024 09:35 Vendim per refuzimin te kerkeses per rishqyrtim 02 021.pdf
Hape: Shqip

Fillimisht është pezulluar procedura në fjalë, dhe pastaj është refuzuar kërkesa jonë për rishqyrtim.
Ju lutem gjeni të bashkangjitur përgjigjjen në kërkesën për rishqyrim, ku AK hedh poshtë pa ndonjë arsyje të bazuar në dispozita ligjore, pretendimet tona të cilat kanë bazë ligjore.

SH. P. K. clastertech PRISHTINE

Përkundër publikimit me datë 26.06.2024nga AK bashkarisht, të Raportit të Rivlerësimit dhe Vendimit të AK-së, për shkak të problemeve të rrjetit qoftë të AK-së apo platformës, Vendimi i AK-së nuk është publikuar!

Dhe, duke respektuar afatet ligjore të LPP-së, me datë 03.07.2024 kemi publikuar edhe Njoftimin për Dhënje të Kontratës!

Pretendimi nr. 2:

Komisioni Vlerësues ka konstatuar se Certifikata e kërkuar në FDT, për pozitën e ofertuar nga OE „CLASTERTECH" SH.P.K., nuk ka deshmuar as në CV-në e prezantuar e as në Certtifikatat e bashkangjitura, por Cetifikata e kontestuar është paraqitur te pozita tjetër, që komisioni ka ardhur në konkludim se nuk është e nevojshme të kërkohen informata sqaruese rreth kësaj.

Pretendimi nr. 3:

Kriteri i lartëcekur „çmimi më i ulët", konsiderohet si i vlefshëm për OE të përgjegjshëm në të gjitha kërkesat administratiuve dhe teknike.

Andaj, duke u bazuar në këto që u thanë më lartë, AK NH „Ibër Lepenc" Sh.a. e refuzon Kërkesën për Rishqyrtim nga "CLASTERTECH" SH.P.K.

Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të bëjë ankesë në OSHP.

Vendimi publikohet:

Në platformën elektronike të prokurimit në adresën: https://e-prokurimi.rks-gov.net

Në dosjen e tenderit të kësaj procedure, te kërkesat mbi mundësitë teknike dhe / ose profesionale është kërkuar nga AK:

SH. P. K. clastertech PRISHTINË

3. Një-1-zyrtar te certifikuar për "Microsoft 365 Certified Fundamentals", ose Microsoft 365 Certified Teams Administrator Associate , me pervojë se paku dy-2 vjeçare ne fushen e ngjajshme. Zyrtari mund të jetë në kuadër të stafit te Operatorit ose edhe me marrëveshje bashkepunimi, e cila duhet të mbulojë tërë kohëzgjatjen e kontrates.(Kopja e diplomes ose certifikatës për përgaditje. **4. Një 1 zyrtar te certifikuar për siguri të infrastruktures ne cloud dhe cybersecurity architect expert, me përvojë së paku dy-2 vjeçare ne fushen e ngjajshme. Zyrtari mund te jete ne kuader te stafit te Operatorit ose edhe me marrëveshje bashkëpunimi, e cila duhet të mbulojë tërë kohëzgjatjen e kontratës. (Kopja e diplomes ose certifikatës për përgaditje.** **5. Një-1-zyrtar te certifikuar për siguri te rrjetave, me përvojë se paku dy-2 vjeçare në fushën e ngjajshme. Zyrtari mund të jetë ne kuadër të stafit të Operatorit ose edhe me marrëveshje bashkëpunimi, e cila duhet të mbulojë tërë kohëzgjatjen e kontratës.**	**3. Kopja e kontrates së punës ose marrëveshj bashkëpunimit dhe CV e cila deshmon përvoj kërkuar.** **4. Kopja e kontrates së punës ose marrëveshj bashkëpunimit dhe CV e cila dëshmon përvoj kerkuar.** **5. Kopja e diplomes ose certifikatës përgaditje, Kopja e kontrates së punës marrëveshjes së bashkëpunimit dhe CV e dëshmon përvojen e kerkuar.**

Ne si OE, gjatë përgaditjes së dokumenteve për aplikim në këtë procedurë, kemi interpretuar këtë kërkesë se nuk ndalohet propozimi i një zyrtarit i cili posedon të gjitha këto çertifikime, sepse nuk ka qenë e cekur në asnjërën kërkesë se nevojiten tre (3) individë të ndryshëm. Gjithësesi ne kemi dërguar CV-të për tre (3) zyrtarë. Pas kërkesës së qasjes në dokumenta të OE i shpallur si fitues jemi njoftuar gojarisht nga zyrtarja e prokurimit se arsyeja për mos-selektimin tonë ka qenë mungesa e një çertifikate të zyrtarëve të propozuar. (Arsyje të cilën ne akoma nuk e kemi pranuar me shkrim se ka qenë mungesa e certificates arsyje për të cilën ne shpallemi si tenderues I pasuksesshëm)

Ne kemi dërguar stafin e kualifikuar i cili mbulon të gjitha çertifikimet.

Zyrtari I propozuar, Rexhion Qafa, posedon të gjitha çertifikimet e kërkuara.

Gjithësesi ne kemi propozuar tre individë për këtë procedurë:

- *Frosina Kostovska – Zyrtarja me certifikatë e propozuar për "Microsoft 365 Certified Fundamentals"*
- *Rexhion Qafa dhe - Zyrtari me të gjitha certifikimet i propozuar për "Siguri të infrastruktures ne cloud dhe cybersecurity architect expert"*
- *Lulzim Rahimi – Zyrtari me diplomë i propozuar për "Siguri te rrjetave"*

Sipas udhëzuesit nr.001/2023 për prokurim publik, pika 10 Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve, tabela 10.1 ku janë marrur shembuj që mund të hasen gjatë procedurave tenderuese, ceket se:

CV-ja e dorëzuar nuk përmban informatat e kërkuara, AK nuk mund të vendos	**Mund të kërkohen informata sqaruese**	**69**

Po të njejtën dispozitë ligjore e mbështetë edhe "Neni 72 Dokumentacioni dhe Informacioni Shtesë" i Ligjit për Prokurimin Publik të Kosovës, si dhe "Neni 38 Sqarimi i Tenderëve" i Rregullorës nr.001/2022 për Prokurim Publik

SH. P. K. Clastertech PRISHTINË

Po e ricekim se sipas ligjit, rregullores e udhëzuesit, AK është dashur të kërkojë sqarime shtesë konform legjislacionit në fuqi të cekur më lart. (edhe pse kemi dërguar individin me të gjitha certifikimet).

Duke marrur parasysh se rregullorja në fuqi që, rregullorja në të cilën ne po bazohemi, është në harmoni të plotë me Ligjin për Prokurim Publik të Kosovës, AK përsëri nuk e ka marrur parasysh si të bazuar kërkesen tonë. Kjo gjë e përforcon edhe më shumë argumentin tonë se ne jemi diskriminuar në proceduart e vlersimit të tenderit nga AK, pasi që nuk ka vepruar sipas rregullores se cekur me lart për rastin në fjalë.
Duke shpallur OE-në "Infosoft Systems" si operator fitues, AK po shkel dispozitën ligjore "Neni 7 Barazia në trajtim / Jo – diskriminimi, paragrafët 1, 2, 3 dhe 4" paragrafe të cilat flasin për ndalimin e AK që të favorizoj një OE.

Neni 7
Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

1. Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

3. Pa e cenuar paragrafin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përmbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përmbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përzgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

SH. P. K. Clastertech PRISHTINË

clastertech

Clastertech Kosove
Ukshin Hoti C4/2,Lok Nr: 8
10000 Prishtinë - Kosovë

Clastertech Albania
Emin Duraku, Njësia Nr: 5
1001, Tiranë - Albania

Sipas kriterit të dhënë nga AK për dhënie të kontratës, Clastertech Sh.P.K përmbushë të gjitha kriteret siç është vlersuar fillimisht.

Kriteret e Dhënies	31.1	Tenderi i përgjegjshëm me **Çmimin më te ulët** ☒ apo Tenderi i përgjegjshëm **ekonomikisht më i favorshëm** i përcaktuar sipas kriterit të peshës së nën-kritereve të përshkruara Aneksin 6 ☐

Po ashtu me çmimin më të ulët me një ofertë prej 17,633.63 euro, kurse operatori ekonomik I shpallur fitues ka një ofertë prej 23,496.75.

Po ju drejtohemi juve, si instancë më e lartë, të mernni një vendim, bazuar në dispozitat, dëshmitë dhe faktet nga ana jonë.

Të bashkanjgitur me këtë ankesë do të gjeni edhe kërkesën për rishqyrtim të parashtruar nga ne, së bashku me vendimet e cekura më lartë, si dhe dokumentet tjera relevante për këtë procedure prokurimi.

Me respekt,
Arton Vllasa

CEO
Clastertech

Clastertech Kosove
Ukshin Hoti C4/2,Lok Nr: 8
10000 Prishtinë - Kosovë

info@clastertech.com
www.clastertech.com
+383 38 726 700